



## **Raport nga procesi i dëgjimeve publike me qytetarë për Kornizën Afatmesme Buxhetore (KAB) 2026–2028**

Komuna e Istogut ka organizuar proces të dëgjimeve publike me qytetarë lidhur me Kornizën Afatmesme Buxhetore (KAB) për periudhën 2026–2028, me qëllim të përfshirjes së qytetarëve dhe bashkësive lokale në procesin e planifikimit buxhetor afatmesëm dhe përcaktimit të prioriteteve zhvillimore të komunës.

Korniza Afatmesme Buxhetore përbën dokument strategjik financiar që përcakton orientimet kryesore buxhetore për një periudhë trevjeçare dhe shërben si bazë për hartimin e buxheteve vjetore. Në këtë kontekst, Komuna e Istogut ka vlerësuar si të domosdoshme organizimin e dëgjimeve publike në nivel të bashkësive lokale, me qëllim të identifikimit të nevojave reale të qytetarëve.

Dëgjimet publike janë mbajtur në bashkësitë lokale Rakosh, Saradran, Vrellë, Gurraçoc, Banjë dhe Istog. Takimet janë shpallur paraprakisht përmes uebfaqes zyrtare të komunës dhe kanaleve të tjera të informimit publik, duke u mundësuar qytetarëve pjesëmarrje të hapur dhe aktive.

Gjatë dëgjimeve publike, përfaqësuesit komunalë prezantuan përmbajtjen e Kornizës Afatmesme Buxhetore, duke sqaruar strukturën e planifikimit financiar, prioritetet strategjike, kufijtë buxhetorë dhe fushat kryesore të investimeve të planifikuara për periudhën 2026–2028. U theksua rëndësia e planifikimit realist dhe të qëndrueshëm, në përputhje me kapacitetet financiare të komunës.

Qytetarët pjesëmarrës nga secila bashkësi lokale paraqitën kërkesa dhe sugjerime konkrete lidhur me investimet në infrastrukturë rrugore, furnizimin me ujë të pijshëm, ndriçimin publik, përmirësimin e objekteve shkollore, mbështetjen për bujqësi dhe shërbimet komunale. Gjithashtu, u theksua nevoja për shpërndarje më të balancuar të investimeve ndërmjet zonave urbane dhe rurale.

Të gjitha komentet, kërkesat dhe sugjerimet e qytetarëve janë evidentuar nga zyrtarët përgjegjës dhe do të shqyrtohen gjatë procesit të finalizimit të Kornizës Afatmesme Buxhetore.

### **METODAT E KONSULTIMIT**

Nr.	Metoda e konsultimit	Lokacioni
1	Dëgjim publik me qytetarë	Rakosh
2	Dëgjim publik me qytetarë	Saradran
3	Dëgjim publik me qytetarë	Vrellë
4	Dëgjim publik me qytetarë	Gurraçoc
5	Dëgjim publik me qytetarë	Banjë
6	Dëgjim publik me qytetarë	Istog